

REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC  
KABINETI I KRYETARIT E KOMUNES/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)  
Nr./Br./No 562 Nr. i faq./Br.str./No pe 221  
Data/Datum/Date 9/6/21  
RAHOVEC / ORAHOVAC

KOMUNA RAHOVEC



# BULETINI MUJOR KOMUNAL PRILL 2021

**PËRMBAJTJA**

|                                                            |    |
|------------------------------------------------------------|----|
| HYRJE.....                                                 | 2  |
| AKTIVITETE TË KRYETARIT DHE DREJTORËVE TË DREJTORIVE ..... | 3  |
| PËRFUNDIM.....                                             | 13 |

## HYRJE

*Ky organ botues është krijuar me idenë fillestare të promovimit të aktiviteteve të Kryetarit të Komunës dhe drejtorëve të drejtorive përgjatë muajve të vitit 2021, rëndësia e botimit të buletinit disa herë në vit qëndron në dhënien e mundësisë për informacionet mbi vendimet, zbatimin e politikave dhe rezultatet e aktiviteteve të Komunës së Rahovecit në mënyrë të tillë që të mundësojmë që qytetari të ndjekë dhe të kontribuojë në mënyrë efektive në punën e institucioneve lokale.*

*Me anë të këtij buletini mujor për muajin prill ne jemi munduar të paraqesim me fotografi dhe në detaje aktivitetet nga ana e Kryetarit të Komunës dhe drejtorëve të drejtorive në Komunën e Rahovecit.*

## AKTIVITETE TË KRYETARIT DHE DREJTORËVE TË DREJTORIVE



I shoqëruar nga nënkryetari, z. Fatmir Iska, drejtori i DSHMS-së, z. Samir Mustafa dhe drejtori i QKMF-së, z. Elbunit Kryeziu, Kryetari, z. Smajl Latifi ka takuar punonjësit shëndetësor të QKMF-së "Fahredin Hoti" në Rahovec.



Në Hoçë të Vogël, Kryetari Latifi, bashkë me drejtues të organizatave të dala nga lufta e UÇK-së, familjarë të dëshmorëve e martirëve dhe me bashkëpunëtorë, kujtuan dëshmorët dhe martirët e lirisë!

Kryetari Latifi, bashkë me drejtues të organizatave të dala nga lufta e UÇK-së, familjarë të dëshmorëve e martirëve dhe me bashkëpunëtorë, përkujtuan 22 vjetorin e sulmit mbi fshatin Nagac, ku familje e qytetarë të shumtë edhe të fshatrave të tjerë, që ishin mbledhur për t'i shpëtuar egërsisë serbe, përjetuan tmerrin nga bombardimet e aeroplanëve luftarak të Serbisë, që ua morën jetën dhjetëra qytetarëve të strehuar.







Kryetari, z. Smajl Latifi me bashkëpunëtorë, përfaqësues nga organizata e veteranëve të luftës së UÇK-së, bashkëluftëtarë, familjarë të të rënëve, përkujtuan katër dëshmorët e Pataqanit të Ulët: Reshat Zekën, Sadki Sylejmanin, Bekim Ahmetin dhe Namik Zekën, si dhe tre qytetarët e vrarë nga forcat pushtuese serbe: Shemsie Hotin, Sutki Hotin nga Pataqani i Ulët dhe Ferat Dakën nga Rahoveci.

Kryetari Latifi së bashku me Shefin e ZKKK-së, Lendrit Qelin, kanë nënshkruar Marrëveshje Bashkëpunimi në mes të Organizatës Ndërkombëtare për Migracion-IOM dhe komunës së Rahovecit, për 2 projekte kapitale në vendbanimet e komuniteteve jo-shumicë të komunës sonë: "Rregullimi i shtratit të përroit në fshatin Brestoc" dhe "Rregullimi i çatisë së Qendrës Kulturore në fshatin Hoçë e Madhe".



Në kujtim dhe nderim të sakrificës sublime për lirinë e atdheut, në 22 vjetorin e rënies në fushëbetejë të "Rrezet e Krushës", Kryetari, z. Smajl Latifi me bashkëpunëtorë, përfaqësues nga organizata e veteranëve të luftës së UÇK-së, bashkëluftëtarë, familjarë të të rënëve nderuan kujtimin për jetën, veprën dhe sakrificën e bashkëluftëtarëve dëshmorë, Dalip Behra dhe Bekim Gashi.



Në Fortesë përuruar ndriçimin publik në gjatësi 4300 metra (127 poça), ku përfshihen 6 rrugë, pra, 80% e fshatit mbulohet me ndriçim publik. Ndriçimi publik, veç tjerash, rrit sigurinë e qytetarëve tanë!

Në 22- vjetorin e hyrjes në pavdekësi të dëshmorëve të kombit, Visar M. Hoti dhe Safet L. Latifi.

I paharruar është kujtimi për Visarin dhe Safetin dhe për të gjithë dëshmorët e kombit.

Lavdi jetës dhe veprës së tyre!



Kryetari Latifi me bashkëpunëtorë, përfaqësues nga organizata e veteranëve të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, bashkëluftëtarë, familjarë të të rënëve, në 22 vjetorin e rënies kujtuan veprën dhe sakrificën e dëshmorit Hamëz Thaçi nga Xërxa, i cili ra heroikisht në betejën e Koshares.



Kryetari, z. Smajl Latifi, ka pritur në një takim pune, drejtorin ekzekutiv të rrjetit të KEDS-it, z. Alpin Dogan me bashkëpunëtorët z. Fadil Fazliun dhe z. Fidan Dushin, me të cilin ka biseduar për gjendjen energjetike, furnizimin me energji elektrike dhe mundësinë e investimeve të reja në komunën e Rahovecit. Pjesë e investimeve në rrjetin elektrik, e që pritet të fillojnë këtë vit janë: Dejani, Pataqani, Kramoviku 1, Kazniku, Hoça e Madhe 1.

Kryetari, z. Smajl Latifi bashkë me koordinatoren e grupit për performancë komunale, Bjondina Rama takuan zyrtarët komunal nga të gjitha fushat përgjegjëse për raport të performancës për këtë vit.

Kryetari i ka falënderuar edhe për kontributin që e kanë dhënë vitin e kaluar, sepse falë përkushtimit të tyre ne u vlerësua si një ndër komunat me performancë më të mirë, për vitin 2019!



Në Drenoc, Kryetari Latifi me bashkëpunëtorë, përfaqësues nga organizata e veteranëve të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, bashkëluftëtarë, familjarë të të rënëve përkujtuan 26 Prillin 1998, Ditën e daljes publike të UÇK-së, e cila më pas u përhap si rrufeja në gjithë Anadrininë dhe Zonën Operative të Pashtrikut.





Qëndrimi afër bizneseve në këtë kohë pandemie është mision dhe përgjegjësi institucionale.

Në kuadër të kësaj, Kryetari Latifi me bashkëpunëtorë ka qëndruar në Xërxë dhe Fortesë për të parë punën dhe vështirësitë me të cilat këto biznese po përballen.



Kemi pastruar deponinë legale të mbeturinave të ngurta, e cila ndodhet në dalje të qytetit të Rahovecit, 2.5 km larg tij, në drejtim të fshatit Drenoc. Mjedis i pastër vazhdon të trajtohet me prioritet të lartë në qeverisjen time dhe në këtë frymë, kemi ndërmarr këtë aksion i cili do të vazhdojë edhe ditëve në vijim.



Pas vizitës së drejtorit të DSHP-së me staf, janë zgjidhur mosmarrëveshjet në tejkalimin e problemeve pronësore dhe punimet janë duke shkuar drejt fundit në rrugën "Ali Hasku".

Ky projekt ka zgjidhur shumë probleme, ndër të tjera ka zgjidhur problemin e;

1. Rrjetit të ujërave fekale,
2. Rrjetit të kanalizimit atmosferik, si dhe
3. Rrjetin e ujit të pijshëm...





DSHP ka filluar aktivitetin e pastrimit përmes kompanive që operojnë në komunën tonë për eliminimin e mbeturinave në çdo rrugë rajonale dhe lokale të komunës sonë.



Pastrimi i rrugës rajonale Rahovec-Krushë e Madhe si dhe rruga rajonale Rahovec në drejtim të Suharekës.

Elektrifikimi dhe instalimi i ri i ndriçimit të jashtëm në oborrin e Shtëpisë Muze "Ukshin Hoti" në Krushë të Madhe.






Ndërtimi i depos për ruajtjen e perimeve me komore ftohëse, në rradhë të parë siguron produktet bujqësore, si dhe ofron të ardhurat e kënaqshme gjatë gjithë kohës. Projekti për ndërtimin e komoreve ftohëse për herë të parë po implementohet në Komunën e Rahovecit, gjë që është mirëpritur mjaft mirë nga fermerët të cilët prodhojnë dhe përpunojnë shumë nga prodhimet e tyre bujqësore.

Në kuadër të ndërtimit të serrave për fermerët përfitues, komisionet për verifikimin e ndërtimit të serrave kanë filluar punën e tyre në teren. Deri më tani janë ndërtuar mbi 50% e serrave tek përfituesit, ku të gjitha prej tyre veçse janë mbjellur me kultura të ndryshme perimore.



Për të siguruar më shumë mundësi për masivizim të sportit tek grupmoshat e ndryshme, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, vazhdon të përkrah shkollat e futbollit të komunës së Rahovecit.



Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, vazhdon me pasurimin e bibliotekave në komunën e Rahovecit.

Me këtë rast, janë ndarë rreth 200 ekzemplar me tituj të librave të rinj për fëmijë dhe të rritur, në bibliotekën komunale "Sulejman Krasniqi", si dhe në nëndegët e bibliotekës në Krushë të Madhe dhe në Ratkoc.

Aktivizohen edhe dy Klube të Librave në komunën e Rahovecit.

Duke marrë parasysh rolin dhe rëndësinë e të lexuarit, Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport për nder të Ditës Botërore të Librit, e cila shënohet çdo 23 prill në mbarë botën, ka aktivizuar edhe dy Klube të Librit, një në nëndegën e Krushës së Madhe dhe tjetrën në Ratkoc. Të dyja këto klube kanë për qëllim nxitjen dhe stimulimin e lexueshmërisë së fëmijëve, duke e eksploruar botën edhe përmes leximit.



Shënohet 40-vjetori i Pranverës Shqiptare '81 në Rahovec

Në sallën e mbledhjeve të Kuvendit Komunal të Rahovecit, është mbajtur aktivitet për shënimin e 40-vjetorit të Pranverës Shqiptare '81 në Rahovec.







Mirëmbajtja higjienike dhe dezinfektimi i hapësirave të brendshme dhe të jashtme të shkollave të komunës sonë.



Gjendja e hapësirave të brendshme të shkollës "Vëllezërit Frashëri" në Drenoc tashmë është shumë më e mirë sesa më parë. Në këtë objekt shkollor, përveç zbatimit vitin e kaluar të masave të efijencës së energjisë, përmes projektit të riparimeve kemi bërë montimin e dyerve të reja të klasave dhe lyerjen e mureve të brendshme.



Vazhdojnë punimet në ndërtimin e objektit të ri të shkollës "Tre Dëshmorët" në Vrajakë-Bratotin.





Punimet në riparimin e nyjeve sanitare në Shkollën e Mesme të Lartë "Xhelal Hajda-Toni" janë pothuajse në përfundim! Ishte ky një projekt i rëndësishëm i realizuar nga DKA në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, përmes të cilit po përmirësohet infrastruktura e kësaj shkolle.

**PËRFUNDIM**

*Ky buletin përmbledhës paraqet thekset kryesore të aktiviteteve që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe: (prill 2021).*

*Edhe pse fusha e qeverisjes së mirë është mjaft e gjerë, një aspekt i rëndësishëm i saj që është i pashmangshëm për ta plasuar qytetarin në vend qendror është liria e informimit. Informacioni është themeli i qeverisjes së mirë, jo vetëm sepse e rrit efikasitetin por gjithashtu sepse i fuqizon qytetarët dhe mundëson shpërndarje të barabartë të përfitimeve nga zhvillimi i përgjithshëm në vend, andaj duke dashur që të jetë sa më transparente me publikun, Komuna e Rahovecit përmes këtij dokumenti ka ofruar një pasqyrë të përgjithshme të aktiviteteve të saj, për t'iu dhënë mundësi qytetarëve që të njohin e vlerësojnë punën e institucioneve komunale.*

*Komuna e Rahovecit ka vënë në funksion këto parime përmes formave të ndryshme të komunikimit me qytetarë, takimeve të drejtpërdrejta, informimit publik dhe çfarëdo metode tjetër përmes së cilës transparenca të ndikojë në avancimin e vetëqeverisjes lokale.*

*Përveç konsultimit dhe komunikimit, këto dokumente forcojnë lidhjet e qytetarëve me komunën dhe rrisin besimin që e gëzojnë zyrtarët publik në nivel lokal.*